


POLITIKAT LOKALE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

KOMUNA PRIZREN

JANAR 2015





POLITIKAT LOKALE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

KOMUNA PRIZREN

|||||

COPYRIGHT © 2014. KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. BajramKelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

|||||

PËRMBAJTJA

HYRJE	7
Metodologjia	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
KONTEKSTI INSTITUCIONAL.....	10
Ministria e Shëndetësisë	10
Kompetencat e Komunave në sektorin e shëndetësisë	11
KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR	12
ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE LOKALE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË.....	14
Organizimi i QKMF në ofrimin e shërbimeve parësore dhe sfidat në Prizren	14
LISTËN E ESENCIALE E BARNAVE DHE TRANSPARENCA E KOMUNËS	16
ROLI I KUVENDIT TË KOMUNËS NË ZBATIMIN E POLITIKAVE ZHVILLIMORE NE SHËNDETËSINË PRIMARE	18
IMUNIZIMI I QYTETARËVE DHE SFIDAT	20
SISTEMI I INFORMIMIT SHËNDETËSORË.....	21
BASHKËPUNIMI I QEVERIS LOKALE ME ORGANIZATAT JO-QEVERITARE NË SHËNDETËSI DHE SFIDAT	22
BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR SHËNDETËSINË	23
REKOMANDIMET	25
LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA.....	26

|||||

|||||

|||||

HYRJJE

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në kuadër të realizimit të projektit të saj “Pjesëmarrja e qytetarëve për transparencë dhe llogaridhënie” pos në monitorimin e Kuvendeve të Komunave të Regjionit të Prizrenit, fokus të veçantë i ka dhënë edhe analizave të sektorëve (dikastereve) komunal me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët e Komunave.

Gjendja e sektorit të shëndetësisë në Komunitet e Kosovës është konsideruar në nivel jo të kënaqshëm. Kjo jo-kënaqshmëri e qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore ka ardhur si rezultat i mungesës së gatishmërisë së institucioneve për të avancuar politika dhe qartësimin e kompetencave të institucioneve në sferën e shëndetësisë.

Shëndetësia primare dhe mbrojtja e shëndetit publik duhet të sigurohet nga niveli komunal. Në realizimin e kësaj përgjegjësie, komunitet duhet të kujdesen dhe angazhohen për plane konkrete veprimi dhe politika të qarta për avancimin e mëtejme të shërbimeve primare shëndetësore.

Derisa, Kosova ka të ndarë ofrimin e shërbimeve shëndetësore në tri nivele, niveli i parë apo shëndetësia primare është përcaktuar në kuadër të kompetencave vetanake të komunave. Andaj, në kuadër të kësaj analize të politikës publike në sektorin e shëndetësisë për Komunitetin e Prizrenit do të fokusohemi në infrastrukturën ligjore (kontesti institucional), në politikat e deritanishme në këtë sektorë nga qeveria lokale e Prizrenit dhe rekomandimet për avancimin e mëtejme të këtij sektori nga ana e Komunitetit të Prizrenit.

Kjo analizë e sektorit të shëndetësisë të Komunitetit të Prizrenit duhet të shërbejë si udhërrëfyes për Ekzekutivin dhe Kuvendin e Komunitetit të Prizrenit në ndërmarrjen e masave të menjëhershme në përmirësimin e gjendjes në ofrimin e shëndetësisë primare për gjithë qytetarët e Komunitetit të Prizrenit.

METODOLOGJIA

Analiza e politikës publike në sektorin e shëndetësisë në Komunitetin e Prizrenit është e bazuar në aspektin e bazës ligjore në ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore, dokumente dhe analiza të organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, intervista me Drejtorin e Shëndetësisë, intervista me Drejtorin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), intervista me anëtarë të kuvendit të komunitetit të subjekteve politike dhe intervista me përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile të Komunitetit të Prizrenit.

|||||

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Roli i qeverisjes lokale në hartimin dhe zbatimin e politikave në ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore është kryesore në shëndetin e qytetarëve të një komuna. Si rezultat i mungesës së gatishmërisë së qeverisë lokale në prioritetizimin e sektorit të shëndetësisë, deri tani, kjo e fundit nuk ka prezantuar ndonjë plan operativ për këtë sektor, plan ky i cili do të përcaktonte të gjitha mekanizmat që do duhej të merreshin nga qeveria lokale konkretisht nga Drejtoria e Shëndetësisë si bartëse e politikave lokale në sektorin e shëndetësisë.

Kuvendi i Komunës si institucion më i lartë në vetëqeverisjen lokale nuk duhet të rri indiferent karshizhvillimit të politikave lokale në sektorin e shëndetësisë. Rol kyç i institucionit të kuvendit është rritja e mbikëqyrjes së qeverisë lokale në përgjithësi konkretisht sektorit të shëndetësisë dhe të kërkojë llogaridhënie të vazhdueshme nga ky sektorë në implementimin e politikave në shëndetësinë primare.

Koncepti i mjekësisë familjare nuk është duke u realizuar. Ndarja e pacientëve dhe familjeve ndërmjet Ekipeve të Mjekësisë Familjare dhe Institucioneve të KPSH duhet bërë ashtu që të garantohet e drejta e shfrytëzuesve për të zgjedhur mjekun e tyre dhe për të pasur qasje të lehtë në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në institucionin më të afërt shëndetësorë të KPSH.

Duke parë rendësin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore të kujdesit primarë, Komuna e Prizrenit në politikën e saj zhvillimore të Kujdesit Parësorë Shëndetësorë duhet të riorganizojë tri nga Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) atë të Zhurit, Reqanit dhe Gjonajve me qëllim të operimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore 24 orë si dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore konkretisht në bërjen e analizave laboratorike nga këto qendra. Mungesa e përcaktimit të objektivave të qarta dhe efektive ka bërë që në kuadër të ofrimit të shërbimeve shëndetësore primare; në bërjen e analizave laboratorike të përqendrohen vetëm në dy institucione shëndetësore. Aktualisht, analizat laboratorike ofrimin vetëm në dy nga institucionet shëndetësore, kjo politikë përcillet edhe me pritje të pacientëve nga dy apo tri ditë.

Nga ana e zyrtarëve qeveritarë, problemet e tilla janë arsytuar me mungesën e biokimistëve, fluksin e madh të pacientëve dhe mungesën e personelit mjekësorë. Kjo politikë, në njërin anë do të mundësonte qytetarëve të ulin koston e shpenzimeve të pacientëve në marrjen e shërbimeve shëndetësore primare dhe në anën tjetër do të rriste mundësit e diagnostifikimit të hershëm të sëmundjeve, qëllim dhe synim ky i cili duhet të jetë në politikën e qeverisë lokale të Komunës së Prizrenit.

Funksionalizimi i Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Komunën e Prizrenit mbetet me plot sfida. Pos në regrutimin e specialistëve të mjekësisë urgjente, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë duhet të iniciojë hartimin e Statutit të kësaj qendre dhe miratimin e tij nga ana e Kuvendit të Komunës dhe të jetë institucion i ndarë nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren.

Me qëllim që të kemi një gjithë-përfshirje në politikën shëndetësore, drejtoria e Shëndetësisë përmes QKMF-së duhet të iniciojnë ndryshim-plotësimin e Statutit të QKMF-së. Në ndryshim-plotësimin e Statutit, të përfshihen target grupet e caktuara, që të kemi inpute nga grupet e caktuara dhe qytetarëve në hartimin e statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prizren. Kuvendi i Komunës si themelues i këtij institucioni nuk duhet të rri indiferent dhe si të tillë, në njërin anë duhet të miratojë Statutin e QKMF-së dhe në anën tjetër, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë duhet të shtojë mbikëqyrjen e zbatimit të Statutit nga ana e menaxhmentit të QKMF-së.

|||||

Probleme të theksuara në politikat lokale në sektorin e shëndetësisë paraqesin edhe mungesa e një koordinimi ndërinstucional. Organizimi i brendshëm i QKMF-ve dhe institucioneve tjera shëndetësore në nivel komunal mbeten përgjegjësi e menaxhmentit dhe drejtorisë së shëndetësisë dhe një praktikë jo e mirë e përcaktuar nga ana e menaxhmentit të QKMF-ve është edhe caktimi i pushimit nga ora 09-10 gjatë orarit të punës në institucionet shëndetësore të nivelit lokal si dhe bartja e personelit mjekësorë në institucionet shëndetësore.

Drejtoria e Shëndetësisë bashkë me menaxhmentin e QKMF-ve duhet të mendojnë në drejtim të zhvendosjes së orarit të pushimit gjatë punës dhe organizimin e udhëtimit të personelit mjekësorë ta bartë tek personeli, me qëllim të lehtësimit të qasjes së qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në orët e hershme të ditës.

Një shqetësim i përgjithshëm ndër qytetarët është edhe qasja në barnat nga Lista Esenciale dhe transparenca e institucioneve shëndetësore si kompetencë të nivelit lokal karshi LEB-it. Zyrtarë komunal shprehin se “hapjen e furnizimit me barnat nga Lista Esenciale duhet të bartet si kompetencë në nivel lokal. Kjo formë e bartjes së kompetencave reflekton në përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien më të madhe dhe qytetarët do të jenë përfitues më të mëdhenj”.

Deri në rishikimin e kësaj kompetence, Drejtoria e Shëndetësisë së Komunes së Prizreni duhet të kujdeset në rritjen më të madhe të transparencës me LEB dhe publikimin e saj në ambientet e QKMF-se, AMF-ve dhe institucioneve tjera të shëndetësisë primare.

Sistemi Informativ i Shëndetësisë ka mbetur si projekt i përcaktuar deri më tani. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë të Komunes së Prizrenit duhet të angazhohet edhe më tej në funksionalizimin e Sistemit Informativ të Shëndetësisë. Ky sistem do të kontribuonte në pasqyrimin e përgjithshëm të shëndetit të qytetarëve jo vetëm të Komunes së Prizrenit por edhe në nivel vendi.

Një tjetër pengesë në ushtrimin e kompetencave vetanake në drejtim të ofrimit të shërbimeve parësore shëndetësore mbetet edhe mjetet financiare që planifikohen nga ana e komunës së Prizrenit. Kjo sfidë është pasqyruar edhe në Raportin e Progresit 2014 për Kosovën ku specifikohet se “shpenzimet e shëndetit publik mbeten ndër më të ulëtat në rajon”. Qeveria Lokale e Prizrenit bashkë me Kuvendin e Komunes duhet të rrisin gradualisht buxhetin në sektorin e shëndetësisë posaçërisht nga të hyrat vetanake, të hyra këto të cilat komunat mund ti planifikojnë dhe alokojnë lirshëm në kategoritë e caktuara buxhetore.

Kuvendi i Komunes së Prizrenit gjatë mandatit të kaluar ka miratuar tri politika lokale të cilat në veti ndërthrin edhe komponentin shëndetësorë. Edhe përkundër miratimit të tri politikave lokale, (mos) implementimi i tyre është përcjellë me kritika të shumta për shkak të mungesës së gatishmërisë së qeverisë lokale në mbështetjen më të madhe financiare për implementimin e komponentit shëndetësorë. Organizata e Shoqërisë Civile bashkë me Drejtorin e Shëndetësisë, në momentin e ridizajimit të këtyre politikave lokale duhet të shtojnë përpjekjet për implementimin e komponentin shëndetësor që dalin në kuadër të planeve të veprimit për barazi gjinore, integrimin e komuniteteve RAE dhe planin e veprimit për rininë.

Drejtoria e Shëndetësisë duhet të krijojë partneritet me Organizatat e Shoqërisë Civile në sensibilizimin më të madh të popullatës së komunës së Prizrenit në drejtim të promovimit dhe parandalimit të sëmundjeve dhe në këto aktivitete të përfshihen edhe mjekët dhe personeli tjetër shëndetësor.

|||||

|||||

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të krijimit të Departamenteve të saj ka themeluar edhe Departamentin e Shërbimeve Shëndetësore. Ky Departament ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Monitoron cilësinë e menaxhimit të institucioneve në të gjitha nivelet e sektorit shëndetësor;
- Ofron mbështetje në koordinimin e funksionimit të institucioneve shëndetësore dhe siguron integrimin optimal të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet përfshirë shërbimet e kujdesit emergjentë shëndetësor;
- Siguronndërlidhjen e shërbimeve publike dhe private shëndetësore me shërbimet shëndetësore të ofruara nga organizatat qeveritare dhe jo qeveritare;
- Ndhmon në hartimin e politikave/strategjive dhe legjislacionin që ka të bëjë me shërbimet e kujdesit shëndetësor;
- Monitoron dhe raporton mbi aktivitetet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor që zhvillohen në kuadër të partneritetit publiko – privat;
- Ofron mbështetje në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore në sektorin e infermierisë.

Ky Departament në kuadër të tij ka edhe Divizionin e Kujdesit Parësorë Shëndetësor⁶, kujdes shëndetësor ky i cili hynë në kuadër të kompetencave vetanake të komunave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore primare.

KOMPETENCAT E KOMUNAVE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

Komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit. Komunat i ushtrojnë kompetencat vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin⁷. Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, pos tjerash edhe në ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor dhe shëndetësinë publike⁸. Pra, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, si kompetencë vetanake të komunave ka përcaktuar edhe ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore dhe shëndetësinë publike të territorit të komunës në përgjithësi.

Pos, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) që ka përcaktuar si kompetencë vetanake shërbimet primare shëndetësore edhe legjislacioni tjetër në sektorin e shëndetësisë përkatësisht Ligji për Shëndetësinë ka përcaktuar qartë obligimet e komunave në raport me ofrimin e shërbimeve primare shëndetësore.

Kujdesi shëndetësor sigurohet në nivel: shteti, komune, punëdhënësi, në mënyrë individuale dhe në nivel të shërbimit profesional. Ndarja e aktiviteteve ndërmjet niveleve të kujdesit shëndetësor realizohet në pajtim me strategjinë kombëtare të shëndetësisë, si dhe bazuar në parimin e kujdesit parësor shëndetësor si pikë hyrëse dhe themel të sistemit shëndetësor⁹

⁶ Portali i Ministrisë së Shëndetësisë, <http://msh-ks.org/departamentet/departamenti-i-sherbimeve-shendetesore-2/>

⁷ Neni 15 dhe 16 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

⁸ Neni 17 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

⁹ Neni 15 paragrafi 3 dhe 4 I Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125, <http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

|||||

KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR

Komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre. Komunat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës shërbimeve të mjekësisë familjare¹⁰.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e përkufizon Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH) si "kujdes shëndetësor esencial ne te cilin kane qasje universale individët dhe familjet ne komunitet ne mënyra te pranueshme për ata, përmes pjesëmarrjes se plote te tyre dhe me një kosto qe mund te mbulohet nga komuniteti dhe shteti. Ai përben një pjese integrale te sistemit shëndetësor te shtetit, ne te cilin është bërthama, si dhe te zhvillimit te përgjithshëm social dhe ekonomik te komunitetit"¹¹

Objektivat për shërbimet e kujdesit shëndetësor primar: sigurimi i shërbimeve shëndetësore themelore, të cilësisë të kënaqshme dhe brenda mundësive financiare, rritja e përqindjes së bashkësive familjare që kanë qasje tek uji, 100 përqind në vitin 2015 për vendet urbane dhe 85 përqind në vitin 2015 për vendet rurale, zvogëlimi i prevalencës së kariesit. Numri i karieseve, heqjes dhe mbushjes së dhëmbëve do të duhet të ishte nën 2.5 për 12 vjeçar në vitin 2015. Të dhënat e gjendjes ekzistuese do të jenë në dispozicion në vitin 2015 rritja e mbulimit të shërbimeve parandaluese për 20 përqind. Mbulimi i shërbimeve parandaluese mund të specifikohet dhe matet mes tjerash edhe përmes këtyre aktiviteteve:

- Imunizimi i fëmijëve nën moshën një vjeçare kundër tuberkulozit, difterisë, tetanusit, pertusis, polimielitit dhe fruthit duke matur shkallën e mbulimit me imunizim
- Planifikimi familjar duke matur vlerën e prevalencës së kontracesionit
- Përcjellja e shtatzënisë, duke matur përqindjen e grave që kanë së paku tre vizita gjatë shtatzënisë¹².

MJEKËSIA FAMILJARE DHE SFIDAT NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës t’iu ofrojë kujdes shëndetësor gjithëpërfshirës, të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimit të mjekut familjar i cili do të jetë portë hyrëse për pacientet në sistemin shëndetësor , dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultat në kujdesin parësor dhe në nivele tjera të kujdesit shëndetësor (dytësor dhe tretësorë)¹³.

Sipas strategjisë dhe standardëve të mjekësisë familjare, synohet që një mjek familjarë duhet të ushtron kujdes shëndetësorë për 2000 deri 2500 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së¹⁴. Prej çdo qytetari dhe banori do të kërkohet të përcaktohet për një mjek familjar. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën ku jeton,

¹⁰Neni 18 paragrafi 3,4 dhe 5 I Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125,
<http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

¹¹Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2010-2014,
<http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Strategjia-Sektoriale-e-Shendetesise-2010-2014.pdf>

¹²Neni 4 I Udhëzimit Administrativ 29/2004 për themelimin, organizimin, objektivat dhe veprimtaria e Institucioneve të Kujdesit Primar Shëndetësorë, <http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7235>

¹³Statuti i QKMF-s në Prizren, faqe 2, Mars 2006

¹⁴Ibid, faqe 2

|||||

brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, dhe ka të drejtë ta ndërroj atë¹⁵.

Përcaktimi i zonave është bërë mirëpo duhet të bëhet edhe ndarja e mjekëve sipas familjeve, lista e pacientëve për secilën familje mirëpo kjo është e vështirë të realizohet për shkak të mungesës së kuadrove ngase duhen 70 mjek familjarë që të arrihen standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë¹⁶. Për shkak të mungesës së objekteve adekuate mjekësore, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet e rehabilitimit janë të pamjaftueshme për personat me të ardhura shumë të ulëta, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit që jetojnë në varfëri¹⁷.

Kujdesi shëndetësor zbatohet në institucionin shëndetësor, ose në banesë të qytetarit ose të banorit, si dhe në vende të tjera atëherë kur qytetari ose banori ka nevojë për kujdes shëndetësor emergjent¹⁸. Vizita sistematike për target grupe të caktuara deri më tani nuk ka pas mirëpo do të kemi një projekt me UNICEF-in vitin e ardhshëm që do të vizitohen në shtëpi shtatzënat dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeçare¹⁹.

Ndarja e pacientëve/klientëve dhe familjeve ndërmjet Ekipeve të Mjekësisë Familjare dhe Institucioneve të KPSH duhet bërë ashtu që të garantohet e drejta e shfrytëzuesve për të zgjedhur mjekun e tyre dhe për të pasur qasje të lehtë në shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore në institucionin më të afërt shëndetësorë të KPSH²⁰.

¹⁵ Neni 18 paragrafi 8 dhe 9 I Ligjit për Shëndetësi, <http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

¹⁶ Interviste me z. Mehmedali Gashi, Drejtor I QKMF-se në Prizren

¹⁷ Raporti I Progresit për Kosovën, 2014, [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_\(2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_(2).pdf)

¹⁸ Neni 14 paragrafi 1 I Ligjit për Shëndetësi, <http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

¹⁹ Interviste me z. Mehmedali Gashi, Drejtor I QKMF-se në Prizren

²⁰ Strategjia e Kujdesit parësorë shëndetësorë 2013-2017, Ministria e Shëndetësisë, qershor 2012

|||||

ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE LOKALE NË SEKTORIN E SHËNDETËSISË

Komunat sigurojnë zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese përmes implementimit të konceptit të mjekësisë familjare. Kosova është e ndare në 36 Komuna, ku janë të vendosura institucionet e KPSH-se, respektivisht Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Përveç QKMF-ve, në mesin e institucioneve që ofrojnë kujdes parësor shëndetësor bëjnë pjesë dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Punktet e Mjekësisë Familjare (PMF). Në komunat ku mungon qasja e lehtë në spitale, në kuadër të disa QKMF-ve ekzistojnë edhe maternitetet jashtë-spitalore si dhe Qendrat për Mirëqenien e Gruas (QMG). Qendra e Mjekësisë Urgjente planifikohet të funksionoj në Komunat me tepër se 150.000 banorë²¹.

ORGANIZIMI I QKMF NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE PARËSORE DHE SFIDAT NË PRIZREN

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), në kuadër të zbatimeve të politikave të saj ka të përcaktuar edhe formën e organizimit të ofrimit të shërbimeve parësore shëndetësore. Kësisoj, Komuna e Prizrenit si bartëse e politikave lokale në shëndetin parësor, pos Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ka të funksionalizuar edhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente e cila ka filluar së funksionuari që nga viti shkurti i viti 2014, ka 15 Qendra të Mjekësisë Familjare kemi si dhe 27 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) në lokalitete të ndryshme në territorin e Komunës së Prizrenit.

Qeveria lokale duke mos pasur absolutisht një analizë të mirëfilltë menaxheriale për ekuilibrimin e ndërtimeve të institucioneve shëndetësore, mbulimin me staf profesional si dhe furnizimin optimal të tyre me materiale shpenzuese, ajo po bën ndërtimin e ambulancave shëndetësore duke mos e përfillur absolutisht planifikimin në bazë të nevojave dhe standardeve të përcaktuara me legjislacion aplikativ në Kosovë në të cilat përcaktohet se ku duhet të jenë të vendosura qendrat mjekësore, po përkundrazi pushteti llogaritet dhe analizat po i bën në planin politik partiak duke bërë ndërtime pa planifikim dhe mbulim²².

QENDRAT E MJEKËSISË FAMILJARE

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren operon edhe me 15 Qendra të Mjekësisë Familjare duke pasur shtrirje në tërë territorin e Komunës së Prizrenit. Duke parë rendësin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore të kujdesit primarë, Komuna e Prizrenit në politikën e saj zhvillimore të Kujdesit Parësorë Shëndetësorë duhet të riorganizojë tri nga Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) atë të Zhurit, Reqanit dhe Gjonajve me qëllim të operimit dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore 24 orë nga këto qendra. Aktualisht vetëm QMF-ja në Zhur punon në dy ndërrime derisa Reqani dhe Gjonaj për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore nuk punojnë²³.

Një problematik tjetër e identifikuar paraqet edhe bartja e mjekëve nga QKMF-ja tek QMF-t dhe

²¹ Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2010-2014,

<http://msh-ks.org/ëp-content/uploads/2013/11/Strategjia-Sektoriale-e-Shendetesise-2010-2014.pdf>

²² Intervistë me znj. Mybera Mustafa, Shefe e Grupit Parlamentar, KK, Prizren

²³ Intervistë me z. Memedali Gashi- Drejtori QKMF-së në Prizren

|||||

AMF-t tjera në territorin e komunës së Prizrenit duke shkaktuar vonesa në respektimin e orarit të punës nga personeli që punon në këto institucione shëndetësore. Kjo praktikë duhet të ndryshohet dhe të mbetet përgjegjësi tek personeli çështja e udhëtimit deri në institucionin shëndetësorë.

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Në komunën e Prizrenit, Qendra e Mjekësisë Urgjente ka filluar punën që nga shkurti i viti 2014 si institucion i Kujdesit Primar Shëndetësor. Institucionet e KPSH themelohen në pajtime Planin e rrjetit të institucioneve publike. Aktin e themelimit të institucioneve shëndetësore e nxjerrë Ministria e Shëndetësisë. Institucioni shëndetësorë mund të fillojë veprimtarinë e tij kur Kuvendi Komunal nxjerrë vendim mbi përmbushjen e kushteve për fillimin e punës²⁴. Qendra e Mjekësisë Urgjente është e licencuar por në të ardhmen duhet të shikohen mundësit e regrutimit të specialistëve të mjekësisë urgjente²⁵.

Pos në regrutimin e specialistëve të mjekësisë urgjente, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë duhet të iniciojë hartimin e Statutit të kësaj qendre dhe e njëjta duhet të miratohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit dhe të jetë institucion i ndarë nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren.

SHËRBIMET LABORATORIKE

Qendrat e Kujdesit Primar Shëndetësor (QKMF, AMF dhe Punktet) do të jenë përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve laboratorike, kur egzistojnë arsyet mjekësore²⁶. Aktualisht, në komunën e Prizrenit shërbimet laboratorike kryhen vetëm në dy nga qendrat e kujdesit primarë shëndetësorë²⁷. Nga ana e zyrtarëve qeveritarë, problemet e tilla janë arsyetuar me mungesën e biokimistëve dhe fluksin e madh të pacientëve. Drejtoria e Shëndetësisë së Komunës së Prizrenit duhet të angazhohet në drejtim të zgjerimit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore konkretisht në analizat laboratorike duke mundësuar që edhe në Qendrat e Mjekësisë Familjare në fshatin Zhurë, Reqan dhe Gjonaj të kryhen analizat laboratorike si dhe eliminimin e pritjeve të pacienteve për të kryer analizat laboratorike.

²⁴ Kapitulli I-rë I Udhëzimit Administrativ 29/2004 për themelimin, organizimin, objektivat dhe veprimtarinë e institucioneve të KPSH-së, <http://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7235>

²⁵ Intervistë me z. Muhamedali Gashi, Drejtor i QKMF-së në Prizren

²⁶ Udhëzimi Administrativ 4/2001 për testet laboratorike që do të bëhen në Qendrat e Kujdesit Primar Shëndetësorë, <http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Nr.4-2001.AlbEngSer.pdf>

²⁷ Intervistë me z. Zyber Rizanaj, Drejtor i Shëndetësisë, Komuna e Prizrenit

|||||

LISTËN E ESENCIALE E BARNAVE DHE TRANSPARENCA E KOMUNËS

Probleme të theksuara, pos në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal paraqet Lista Esenciale e Barnave dhe mbi gjitha transparencën e kësaj liste karshi qytetarëve në nivel lokal. Jo çdo herë, qeveria lokale është treguar transparente në qasjen e LEB-së dhe cilat nga medikamentet e kësaj liste qytetarët mund të gëzojnë të drejtën që t'i marrin pranë barnatoreve.

Një përqindje dukshëm e vogël e të anketuarve nga Prizreni janë të kënaqur me furnizimin me barna dhe mjete në spitale (4% në krahasim me mesataren e kosovarëve 26%) dhe në qendrat e mjekësisë familjare (14% në krahasim me mesataren e kosovarëve 31%)²⁸. Një hulumtim i Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtues (BIRN) identifikon probleme të shumta në sistemin e shëndetësisë në Kosovë, përfshirë këtu edhe barnatoret e furnizuara dobët, pajisjet mjekësore të amortizuara dhe të mangëta, puna e personelit mjekësor e vonuar dhe jo-konsistente, si dhe përfshirja e gjerë në sektorin privat karshi atij publik, stafi që drejton pacientët nga sektori publik në atë privat si dhe forma të ndryshme të korrupsionit²⁹.

Legjislacioni në fuqi, ka dhënë kompetencë nivelit lokal në lidhje me organizimin e Barnatoreve. Lidhur me këtë, drejtorit Komunale të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe QKMF-të kanë për obligim: të pregadisnin dhe mirëmbajnë hapësirat e barnatoreve brenda QKMF-ve dhe QMF-ve sipas normave dhe kushteve të parapara për atë lloj institucioni, të përcaktojnë personat përgjegjës për Barnatoret në objektet e tyre, të identifikojnë personelin shëndetësorë i cili do të punojë në barnatore, të dërgojnë në trajnim personelin e identifikuar posa Ministria e Shëndetësisë me partnerët e saj të pregadisë trajnimin adekuat për këta persona³⁰.

Edhe në aspektin e shpërndarjes së barnave nga Lista Esenciale e Barnave, organet komunale kanë përgjegjësi të theksuar me qëllim që të kemi një shpërndarje më racionale dhe një qasje të qytetarëve të kësaj liste.

Disperizimi i LEB do të bëhet në Barnatoret Qendrore të QKMF- dhe në Barnatoret e QMF ku ekzistojnë kushtet e infrastrukturës dhe ku ka personel të trajnuar. DKSHMS/QKMF duhet të sigurojë punën në dy ndërrime në së paku një barnatore brenda Komunës së vetë. Duhet të vendosin në vend të dukshëm orarin dhe vendin e barnatores kujdestare. Disperizimi i LEB (deri në ndryshim të këtij UA) do të bëhet vetëm me recetë të Mjekut të përgjithshëm, Specialistit të Mjekësisë Familjare dhe të mjekëve konsulentë në Kujdesin Parësorë Shëndetësorë. LEB duhet të vendoset në vend të dukshëm në çdo njësi të QKMF-ve. Mjekët në KPSH duhet të informojnë pacientët nëse një bar nuk është në LEB³¹.

Dështimi i mbikëqyrjes së Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë në vendosjen e LEB-it në vende të dukshme përbën një mekanizëm shtesë drejt mungesës së transparencës karshi qytetarëve për qasjen e barnave nga LEB-i. Jo rrallë herë, qytetarët nuk udhëzohen nga personeli për mundësin e qasjes së

²⁸ Mozaiku i Kosovës 2012, Dhjetor 2012, http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

²⁹ Material Diskutues për të arriturat dhe sfidat në fushën e shëndetësisë, nëntor 2012, Ministria e Integritetit Evropiane, http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Politikat_Shendetesore.pdf

³⁰ Neni i Udhëzimit Administrativ 16/2009 për Disperizimi i Listës Esenciale të barërave në kujdesin parësorë shëndetësorë, http://msh-ks.org/ep-content/uploads/2013/11/Nr.19-2006.Alb_.pdf

³¹ Neni i UA 19/2006 për disperizimin e listës esenciale të barërave në kujdesin parësorë shëndetësorë, http://msh-ks.org/ep-content/uploads/2013/11/Nr.19-2006.Alb_.pdf

|||||

barnave nga LEB-i dhe nuk informohen se cilat nga barnat mungojnë në LEB duke ja pamundësuar qytetarëve një të drejtë të tillë të garantuar me ligj.

Si pasojë e mungesës së gatishmërisë së institucioneve lokale që të jenë më transparentë karshi barnave që ekzistojnë në LEB, gatishmërisë së personelit mjekësorë në udhëzimin dhe informimin e qytetarëve për barnat në LEB, neglizhencës së institucioneve në rritjen e cilësisë së shërbimeve parësore; qytetarët barnat e përshkruar nga personeli mjekësorë e blejnë në barnatoret private duke rënduar buxhetin e tyre të varfër.

Një përqindje e lartë e banorëve të Prizrenit (88%) kanë identifikuar koston e blerjes së barnave si problematike për qasjen në kujdesin shëndetësor. Kostoja e vizitës mjekësore u identifikua gjithashtu si problematike nga një përqindje e ngjashme me mesataren e Kosovës, 60%³².

Një tjetër dimension i këtij problemi dhe që drejtoria e shëndetësisë duhet të ketë fokusin e veçante është edhe në përshkrimin e barnave nga personeli mjekësorë dhe të rekomandohet që në vazhdimësi të përshkruhen barna kost-efektiv me qëllim të mos rëndimit të gjendjes financiare të qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

³² Mozaiku i Kosovës 2012, Dhjetor 2012, http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

|||||

|||||

në Prizren.

Lidhur me këtë, Kuvendi i Komunës si themelues i këtij institucioni nuk duhet të rri indiferent dhe si të tillë, në një të anë duhet të miratojë Statutin e QKMF-së dhe në anën tjetër, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë duhet të shtojë mbikëqyrjen e zbatimit të Statuti nga ana e menaxhmentit të QKMF-së.

|||||

IMUNIZIMI I QYTETARËVE DHE SFIDAT

Komuna harton planin e imunizimit duke u bazuar në Planin e Zgjeruar të Imunizimit. Qendrat e Mjekësisë Familjare bëjnë zbatimin e programit të imunizimit nën mbikëqyrjen dhe vlerësimin e IKSHPK³⁷.

Në përgjithësi, komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha, veçanërisht me rrethana të vështira socio-ekonomike, mungesë të arsimimit, kujdesit të dobët shëndetësor dhe diskriminimit³⁸.

Në vitin 2014 në bashkëpunim me disa organizata joqeveritare kemi organizuar vaksinimin e komuniteteve RAE me qëllim të përfshirjes së tyre në imunizimin³⁹. Praktikrat e tilla duhet të vazhdojnë edhe në vitet tjera. Gjithashtu Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit duhet të implementojë politika të tilla edhe në viset e thella të territorit të Komunës së Prizrenit si dhe të ndërmarrë fushata të përgjithshme senzibilizuese për rëndësinë e imunizimit të qytetarëve pa përjashtim sidomos grupeve të marginalizuara.

³⁷ Neni 21 i Ligjit për Shëndetësinë Publike, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2007_02-L78_al.pdf

³⁸ Raportii Progresit për Kosovën, 2014, [http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_\(2\).pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_(2).pdf)

³⁹ Intervistë me z. Zyber Rizanaj – Drejtorin e Shëndetësisë në Prizren

|||||

SISTEMI I INFORMIMIT SHËNDETESORË

Ministria siguron themelimin, zhvillimin, dhe funksionimin e sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor në gjithë sektorin e shëndetësisë, pavarësisht nga forma e pronësisë, lloji i institucionit dhe organizimi i tij, të bazuar në normativa dhe standarde të përcaktuara nga Ministria (në tekstin e mëtejme, SISH). Të gjitha institucionet shëndetësore si dhe personat përgjegjës juridik dhe fizik janë të detyruar të grumbullojnë të dhënat shëndetësore, t'i ruajnë dhe t'i raportojnë ato në SISH, në pajtim me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria⁴⁰.

Sistemi Informativ i Shëndetësisë është tri (3) vjet si projekt, pajisjet janë shpërnda por ka mbet hala jo funksional për shkak të mos trajnimit të stafit për këtë sistem⁴¹. Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorin e Shëndetësisë të Komunës së Prizrenit duhet të angazhohet edhe më tej në funksionalizimin e Sistemit Informativ të Shëndetësisë. Ky sistem do të kontribuonte në pasqyrimin e përgjithshëm të shëndetit të qytetarëve jo vetëm të Komunës së Prizrenit por edhe në nivel vendi.

⁴⁰Neni 49 i Ligjit për Shëndetësinë, <http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

⁴¹Intervistë me z. Mehmedali Gashi, Drejtor i QKMF-së në Prizren

|||||

BASHKËPUNIMI I QEVERIS LOKALE ME ORGANIZATAT JO-QEVERITARE NË SHËNDETËSI DHE SFIDAT

Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektoral me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare⁴².

Organizata e Shoqërisë Civile bashkë me Drejtorin e Shëndetësisë, në momentin e ridizajimit të këtyre politikave lokale duhet të shtojnë përpjekjet për implementimin e komponentin shëndetësor që dalin në kuadër të planeve të veprimit për barazi gjinore, integrimin e komuniteteve RAE dhe planin e veprimit për rininë⁴³. Bashkë me disa organizata jo-qeveritare kemi organizuar vaksinimin e fëmijëve nga komunitetet RAE dhe kjo praktikë do të rritet dhe zgjerohet⁴⁴.


Po ashtu, Drejtoria e Shëndetësi duhet të krijojë partneritet me Organizatat e Shoqërisë Civile në sensibilizimin më të madh të popullatës së komunës së Prizrenit në drejtim të promovimit dhe parandalimit të sëmundjeve dhe në këto aktivitete të përfshihen edhe mjekët dhe personeli tjetër shëndetësor⁴⁵.

⁴²Neni 18 paragrafi 11 i Ligjit për Shëndetësinë, <http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

⁴³Intervistë me z. Vjosa Curri (Dora Dorës) dhe Indira Elshani (Caritas Kosova)


⁴⁴Intervistë me z. Zyber Rzanaj, Drejtor I Shëndetësisë, Komuna e Prizrenit

⁴⁵Intervistë me z. Jubile Kabashi, Drejtoresh Ekzekutive Qendrës së Strehimit të Grave dhe Fëmijëve në Prizren



BUXHETI I KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR SHËNDETËSINË

Në përputhje me politikat ekonomike kombëtare dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe Qeverisë, Komunitet e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës⁴⁶. Burimet financiare komunale do të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Kushtetutë dhe në LVQL⁴⁷




Ligji për financat e pushtetit lokal i ka mundësuar që Komunitet të kenë burime të mjaftueshme financiare për realizimin e kompetencave të tyre vetanake dhe të deleguara në kuadër të procesit të decentralizimit.

Për realizimin e politikave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore ndaj qytetarëve duhet të alokohen edhe mjete të mjaftueshme buxhetore gjatë procesit të planifikimit buxhetorë.

⁴⁶ Neni 2 I Ligjit për financat e pushtetit lokal, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

⁴⁷ Po aty neni 2.2.





Në vitin 2014, Drejtoria për Shëndetësi kishte planifikuar afro 4,169,189.00 Euro derisa për vitin 2015 janë planifikuar 4,453,276.00 Euro buxhet për të gjitha kategoritë buxhetore. Nga këto, planifikimet e vitit 2015 krahasuar me vitin 2014, në kategorin paga dhe mëditje kemi një rritje prej 11 %, për mallra dhe shërbime kemi një zvogëlim prej 2 %, për shpenzimet komunale kemi një planifikim të njejtë prej 2 %, për shpenzimet kapitale për vitin 2015 kemi një rënie prej 10 % derisa për subvencione janë planifikuar vetëm 1%.

Për të mirë të popullsisë së komunës, Kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutiv kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t’i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm⁴⁸. Shërbimi primar shëndetësor nuk ka qenë prioritet, kjo mund të shihet edhe për nga ndarja e buxhetit dhe menaxhimi jo i mirë i investimeve të pakta që janë bërë nga ana e qeveris lokale⁴⁹.

Me qëllim që të kemi shërbime shëndetësorë primare dhe qëndrueshmëri financiare në ofrimin e këtyre shërbimeve, Ekzekutivi Komunal duhet të rrisin gradualisht buxhetin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Kuvendi i Komunës së Prizrenit të rrisin mbikëqyrjen e këtij dikasteri me qëllim që qytetarët e Komunës së Prizrenit të jenë përfituesit e politikave të mirëfillta në sektorin e shëndetësisë.

⁴⁸ Neni 2.3 i Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

⁴⁹ Intervistë me z. Arber Rexhaj (LVV), anëtarë i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

|||||||

REKOMANDIMET

- Të hartohet Plani Operativ nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe të shqyrtohet nga ana e Kuvendit të Komunës për procedim të mëtejshëm
- Kuvendi i Komunës së Prizrenit duhet të rrisë mbikëqyrjen e politikave shëndetësore të implementuara nga ekzekutivi komunal
- Të iniciohet hartimi i Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente dhe të miratohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit me qëllim që ky institucion të jetë i ndarë nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Prizren.
- Të regurutohen specialist të Mjekësisë Urgjente për Qendrën e Mjekësisë Urgjente
- Të themelohet Këshilli Mbikëqyrës i Institucioneve të Kujdesit Parësorë Shëndetësor në Komunën e Prizrenit
- Të ofrohen shërbime 24 orë dhe shërbimet laboratorike në tri nga Qendrat e Mjekësisë Familjare (Zhur, Reqan dhe Gjonaj)
- Të zhvendoset orari i pushimit gjatë punës me qëllim të lehtësimin të qasjes së qytetarëve në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në orët e hershme të ditës.
- Të ndahen pacientët dhe familjet ndërmjet Ekipeve të Mjekësisë Familjare me qëllim të implementimit të konceptit të mjekësisë familjare
- Të iniciohet plotësimi ndryshimi i Statutit të QKMF-së në Prizren dhe miratimi i tij nga ana e Kuvendit të Komunës së Prizrenit si themelues i saj
- Ministria e Shëndetësisë duhet të bartë kompetencën nga niveli qendror në nivel lokal për furnizim me barna nga Lista Esenciale
- Të publikohet Lista Esenciale e Barnave brenda QKMF-s dhe AMF-ve
- Të rritet gradualisht buxheti në sektorin e shëndetësisë me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët e Komunës së Prizrenit
- Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Komunën e Prizrenit duhet të shtojnë përpjekjet në funksionalizimin e Sistemit Informativ Shëndetësor
- Të krijohet partneritet me OSHC-n në sensibilizimin dhe edukimin e popullatës me qëllim të promovimit dhe parandalimit të sëmundjeve si dhe personeli mjekësorë të jetë pjesë e fushatave të tilla senzibilizuese
- Të mbështeten plotësisht tri nga politikat publike (Plani i veprimit për Rini, Barazi gjinore dhe Plani i veprimit për integrimin e komuniteteve RAE) në komponentin shëndetësorë.

|||||||

|||||

LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA

Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

<http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

Ligjit për Shëndetësinë Nr. 04/L-125

<http://assemblykosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20shendetesi.pdf>

Ligjit për Shëndetësinë Publike, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2007_02-L78_al.pdf

Ligjit për financat e pushtetit lokal, http://assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf

Portali i Ministrisë së Shëndetësisë, <http://msh-ks.org/fusheveprimi/>

Udhëzimit Administrativ 29/2004 për themelimin, organizimin, objektivat dh veprimtaria e Institucioneve të Kujdesit Primar Shëndetësorë, <http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=7235>

Udhëzimi Administrativ 4/2001 për testet laboratorike që do të bëhen në Qendrat e Kujdesit Primar Shëndetësorë, <http://msh-ks.org/wpcontent/uploads/2013/11/Nr.42001.AlbEngSer.pdf>

Udhëzimit Administrativ 16/2009 për Disperizimi i Listës Esenciale të barërave në kujdesin parësorë shëndetësorë, http://msh-ks.org/ep-content/uploads/2013/11/Nr.19-2006.Alb_.pdf

Udhëzimi Administrativ 03/2005, për themelimin, detyrat dhe përbërja e Këshillave Mbikëqyrës të Institucioneve Shëndetësore, <http://gzk.rksgov.net/ActDetail.aspx?ActID=7253>

Strategjia sektoriale e shëndetësisë 2010-2014,

<http://mshks.org/wpcontent/uploads/2013/11/Strategjia-Sektoriale-e-Shendetesise-2010-2014.pdf>

Strategjia e Kujdesit parësorë shëndetësorë 2013-2017, Ministria e Shëndetësisë, qershor, 2012
Mozaiku i Kosovës 2012, dhjetor 2012,

http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216825.pdf

Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, [http://www.meiks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_\(2\).pdf](http://www.meiks.net/repository/docs/Final_20141008-kosovo-progress-report_en_(2).pdf)

Material Diskutues për të arriturat dhe sfidat në fushën e shëndetësisë, nëntor 2012, Ministria e Integritetit Evropian,

http://www.meiks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Politikat_Shendetesore.pdf

Raporti i Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë, janar-dhjetor 2014, dhjetor 2014, Komuna e Prizrenit
Statuti i QKMF-s në Prizren, mars 2006

|||||

Intervistat:

- z. Zyber Rizanaj – Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Komuna e Prizrenit
- z. Mehmedali Gashi- Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren
- znj. Mybera Mustafa – Shefe e grupit parlamentar nga LDK, Komuna e Prizrenit
- z. Arber Rexhaj, Anetarë i Kuvendit të Komunës së Prizrenit
- znj. Vjosa Curri, Dora Dorës
- znj. Jubilea Kabashi, Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve - Prizren
- znj. Indira Elshani, Caritas Kosova



LOCAL POLICIES IN HEALTH SECTOR

PRIZREN MUNICIPALITY



|||||

COPYRIGHT © 2014. KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI).

Kosova Democratic Institute reserves all rights to this report and no part of this publication is subject to reproduction or retransmission in any mechanical or electronic form, including photocopying or storing in retrieval system of materials without the publisher’s prior authorisation in writing. This publication can be reproduced or transmitted only for non-commercial purposes. Whosoever intends to use excerpts or documents from this publication is obliged to clearly attribute the source wherever and whenever the excerpts or materials are reproduced.

Should you have any comments, criticism or suggestions, you are kindly requested to contact the publisher through any of the following means:

Address: Rr. BajramKelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publication of this report was made possible by the generous support of Olof Palme International Center. The opinions, findings and recommendations expressed herein are those of Democracy in Action and do not necessarily reflect the views of donor.


|||||

CONTENT

INTRODUCTION.....	33
Methodology.....	33
EXECUTIVE SUMMARY.....	34
INSTITUTIONAL CONTEXT.....	36
Ministry of Health.....	36
The competencies of Municipalities in healthcare sector.....	37
PRIMARY HEALTHCARE.....	38
ORGANIZATION OF LOCAL INSTITUTIONS IN HEALTHCARE SECTOR.....	40
Organization of MCFM in providing primary services and challenges in Prizren.....	40
ESSENTIAL LIST OF MEDICAMENTS AND TRANSPARENCY IN MUNICIPALITY.....	42
THE ROLE OF MUNICIPAL ASSEMBLY IN APPLYING DEVELOPING POLICIES IN PRIMARY HEALTHCARE.....	44
IMMUNIZATION OF CITIZENS AND CHALLENGES.....	46
HEALTHCARE INFORMATION SYSTEM.....	47
COOPERATION OF LOCAL AUTHORITIES WITH NON-GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS ON HEALTHCARE AND CHALLENGES.....	48
RECOMMENDATIONS.....	51
THE LIST OF USED SOURCES.....	52

|||||

|||||



INTRODUCTION

Kosova Democratic Institute (KDI) while implementing its project “participation of citizens for transparency and accountability”, besides monitoring the Municipal Assemblies of Prizren Region, has given a special focus also to analysis of municipal sectors (departments) in order to offer better services to citizens of Municipalities.

Condition of healthcare sector in Municipalities of Kosova is considered to be on unsatisfactory level. This dissatisfaction of citizens about healthcare services is due to the lack of readiness of institutions to improve policies and clarify competencies of institutions in the field of healthcare.


Primary healthcare and protection of public health should be provided by the municipal level. To achieve these municipalities should take care and engage in compiling concrete plans of action and clear policies to further improve primary healthcare services.

Healthcare services in Kosova are divided in three levels; first level or primary healthcare is set to be within the competencies of municipalities. Hence, within this analyse of public politics in the healthcare sector for Prizren Municipality, we will be focusing in legal infrastructure (institutional contest), in actual policies in this sector by Prizren local government and recommendations to further improve this sector by Prizren Municipality.

The analyse of healthcare sector of Prizren Municipality should serve and a guideline for the Executive of Prizren Municipal Assembly in taking immediate measures in improving the condition in offering primary healthcare services for all citizens of Prizren Municipality.

METHODOLOGY

